



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS**

V E N D I M
Nr. 24, Datë 02.06.2016

Për Krijimin e Shoqërisë Aksionare të Ujësjellës Kanalizime Vau Dejës, dhe miratimin e Statutit

Në përputhje me Ligjin nr. 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", neni 23 pika 1 dhe pika 2, neni 54 pika "d", neni 55 pika 3 dhe pika 6, Ligji nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Vkm nr 63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik", i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës në mbledhjen e datës 02.06.2016, me propozim të Sektorit Juridik dhe Kryetarit të Bashkisë, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur prej tyre, në kuadrin e riorganizimit të shërbimit të furnizimit dhe ujë të pijshëm dhe kanalizimeve, në formën e shoqërive aksionare me një nivel,

V E N D O S I :

1. Krijimin e Shoqërisë Aksionare "Ujësjellës Kanalizime Vau Dejës", me kapital themeltar 10,000,000 (dhjetë milion) lekë, me pronar 100% Bashkia Vau Dejës.
2. Miratimin e "Statutit të Shoqërisë Aksionare "Ujësjellës Kanalizime Vau Dejës", sipas lidhjes 1 bashkëlidhur, e cila është pjesë integrale dhe e pandashme e këtij vendimi.
3. Shoqëria aksionare që do të krijohet do të jetë me një nivel drejtimi, konkretisht me këto organe: këshilli i administrimit i përbërë nga 3 (tre) anëtar, njëri nga të cilët është administratori.
4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë që të bëjë emërimet e organeve përkatëse, të nënshkruajë aktin e themelimit të shoqërisë si dhe ndjekë të gjitha procedurat e rregjistrimit në QKB.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
6. U shpall sot me date 10/06/2016.

SEKRETARI
Gentian NDOJ



KRYETARI
Martin MARKU